

VENDIM
Nr.199/4, datë 26.12.2003

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK “PERLA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “ Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores "Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.030/FML, të rinovojë për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë subjektin “Valezeri” sh.a., për radion “Perla”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2004 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sefedin Çela